




KRYETARI I KOMUNËS

Raport për takimin e parë me qytetarë për periudhën Janar-Qershor 2021

Të nderuar qytetarë të Komunës së Malishevës,

Sikur çdo vit tjetër, edhe në këtë vit, unë si kryetar i komunës dhe e tërë qeveria komunale, jemi munduar dhe kemi bërë përpjekje maksimale për realizimin e objektivave të përcaktuara dhe të planifikimeve, të cilat konsideroj kemi arritur ti realizojmë në masë të madhe, edhe pse në gjysmën e parë të këtij viti, jo vetëm ne se komunë, por i tërë vendi, jemi përballur me pandeminë e COVID-19, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në të gjitha sferat e jetës, e natyrisht edhe në punën e institucionit të komunës.

Pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia, ne, krahas menaxhimit të kësaj shtate të krijuar, në të njëjtën kohë jemi marrë edhe me realizimin e objektivave, përkatësisht me menaxhimin e punëve tjera, duke filluar nga ofrimi i shërbimeve për qytetarët, deri tek realizimi i investimeve kapitale.

Po ashtu, duhet ta kemi parasysh edhe problemin e mos alokimit të mjeteve për investime kapitale, nga ana e ministrisë së financave, çështje e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në realizimin e projekteve të planifikuara për këtë vit.

Pjesën më të madhe të kohës gjatë këtij gjysmë viti, e ka marrë menaxhimi i gjendjes emergjente në shëndetësi për shkak të pandemisë COVID-19, ku ne si komunë, nga dita e parë e deri në periudhën e parë gjashtë mujore janar- qershor 2021 i kemi marrë të gjitha masat e nevojshme, sipas obligimeve ligjore që i kemi në nivelin lokal. Shtabi emergjent komunal, është aktiv si dhe qendra operative emergjente lokale, dhe janë marrë të gjitha masat tjera për menaxhimin e kësaj shtate, bazuar në Planin e Reagimit Kombëtar. Të nderuar qytetarë, para se të kaloj në prezantimin e punëve dhe obligimeve tjera, më lejoni që ti falënderoj për punën dhe angazhimin e tyre në menaxhimin e kësaj shtate të gjithë ata që kanë qenë të angazhuar drejtpërdrejt, duke filluar nga Shtabi Emergjent Komunal dhe Qendrën Operative Emergjente Lokale, për

angazhimin e tyre 24 orë në ditë, të gjithë punëtorët shëndetësor, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Komunal, të gjitha shërbimet komunale, njësinë për menaxhimin e mbeturinave, të ujërave, postën dhe telekomin, të gjithë ofruesit e shërbimeve të internetit dhe kabllovikut, të gjithë mësimeve për angazhimin e tyre në mësimin online dhe në mësimin e rregullt në shkollë, të gjithë kryetarët e fshatrave për angazhimin e tyre maksimal në shërbim të banorëve të vendbanimeve të tyre, si dhe të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, për maturinë dhe kulturën e tyre të treguar në këtë situatë. Po ashtu, në mënyrë të veçantë i falënderoj të gjithë donatorët, që gjatë kësaj periudhe na kanë ndihmuar si në ushqime, ashtu edhe me mjete mbrojtëse.

Më poshtë janë edhe raportet e drejtorive komunale...

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Komuna e Malishevës, ka një buxhet të miratuar në shumën prej, 14,900,757.00 Eurove. Buxheti aktual i fituar në SIMFK, ku kemi një rritje për shkak të bartjes së disa shumave të vogla të donacioneve nga vitet e mëhershme, pagesa e shtesave për punëtorë shëndetësor për pandemi, zjarrfikës dhe punëtorët social, kap shumën prej, 15.174.620.26 euro.

Deri më tani janë alokuar 6,438,733,83 euro, që do me thënë, rreth 42% e buxhehtit.

Kurse shpenzimi i buxhetit total deri më tani kap shumën, prej, 5,465,987,35 euro, shprehur në përqindje, 36%.

Këto shifra janë në total në buxhetin e KK të Malishevës pa llogaritur mos alokimin e projekteve kapitale në shumën prej, 2,979,590.00 euro, që do me thënë akoma nuk e kemi shfrytëzim (nuk është alokuar).

Pra buxheti, pa kapitale, të alokuar kap shumën, 12,185,030.26 euro, me këtë shumë del se buxheti në këtë periudhë është shpenzuar 45%

Të hyrat vetanake të planifikuar për këtë vit kanë qenë 807,308.00 euro. Deri më tani janë realizuar 459,271.98 euro, së bashku me gjokat e gjykatave dhe trafikut, që domethënë. 57%.

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme të KK të Malishevës,

SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Shërbimi i Gjendjes Civile në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme të KK të Malishevës edhe gjatë muajit Janar- Maj 2021 i ka kryer shërbimet sipas kërkesave të qytetarëve në harmonizim me ligjet dhe rregulloret që aplikohen, Kërkesat janë kryer me kohë dhe gjithherë janë zgjidhur sipas procedurës duke ju përmbajtur afateve ligjore

Tani e japim e raportin e këtij shërbimi si vijon ;

- Aktvendime për ndërrimin, përmisimin e emrit apo të mbiemrit personal.....	19
-Aktvendime për regjistrime me vonesë në LAL.....	86
-Aktvendime për regjistrime me vonesë në LAV.....	36
- Vertetim sqarime të ndryshme.....	01
- Anulime të regjistrimeve në LAL.....	05

Qendra për Shërbim me Qytetarë është pjesë e strukturës organizative të administratës. Përbëhet nga zyrtarët e qendrës për shërbim me qytetarë të cilët kryejnë veprime të shërbimit administrativ si : bëjnë pranimin e kërkesave/parashtresave nga qytetarët dhe subjektet tjera. Këto kërkesa/parashtresa, të kompletuara përcillen në drejtoritë e administratës komunale, varësisht ku pala parashton për shqyrtim dhe vendosje. Pasi që drejtoria përkatëse ka shqyrtuar dhe vendosur lidhur me kërkesën/parashtresën e palës, të njëjta kthehen në QSHQ. Zyrtarët e QSHQ-së, janë të obliguar të njoftojnë qytetarët dhe subjektet e tjera për përgjigjen në kërkesa/parashtresa.

Komunikimin e drejtpërdrejt, korrekt dhe transparent me qytetarët dhe bizneset, dhënien e ndihmës profesionale për paraqitjen e kërkesave dhe parashtresave, njohja e qytetarëve me informacionet e nevojshme lidhur me kushtet, procedurat administrative, ligjore, afatet kohore të paraqitjes dhe trajtimit të kërkesave dhe parashtresave si në formën klasike ashtu edhe përmes formës elektronike/internetit, përgatitja dhe vënia në dispozicion të broshurave dhe fletëpalosjeve informative për qytetarët si dhe publikimin në ueb faqe, mbajtja e dosjeve, statistikave të parashtresave dhe kërkesave të paraqitura nga qytetarët, shtypjen e librit të protokollit për kërkesat/parashtresat, vëzhgimi i reagimeve të qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës ndaj shërbimeve që ofron qendra etj.

Kjo zyre në bashkëpunim me shefin e ofiqarisë posedon kërkesat për korrigjim, ndërrim të emrit dhe mbiemrit, regjistrim të lindjeve dhe vdekjeve me vonesë, si dhe kërkesa të natyrave të ndryshme, ku edhe këto kërkesa regjistrohen, protokollohen, skanohen dhe regjistrohen në protokoll të veçantë në mënyrë zyrtare dërgohet tek zyrtarët kompetent.

Pra, të gjithë këto punë dhe shërbime kryhen në qendrën për shërbim të qytetarëve, gjithherë në shërbim të qytetarëve dhe në bashkëpunim me zyrtarët dhe drejtoratet.

Zyra e Kryetarit

	4. Vendime / 15
	5. Njoftime / 17
1. Kërkesa / 135	6. Raporte / 7
2. Ankesa / 2	7. Marrveshje / 3
3. Aktvendime / 213	8. Urdhëresa ADM.

/ 5

9. Ftesa / 3

10. Përgjigje / 3

11. Të ndryshme /
84

Gjithsej 487

9. Njoftime / 4

10. Vertetime / 1

11. Ankesa / 1

12. Rekomandime
/ 1

13. Propozime / 1

14. Të ndryshme /
33

Gjithsej 328

Kuvendi Komunal

Asambleja Komunale

1. Kërkesa / 112

2. Vendime / 57

3. Procesverbale /
21

4. Raporte / 8

5. Regjistër / /
43 43

6. Thirrje / 20

7. Ftesa / 14

8. Shkresa / 11

Drejtoria e Administratës

1. Kërkesa / 96

2. Vendime / 20

3. Aktvendime / 11

4. Vertetime / 11

5. Regjistrime / 15

6. Korigjime / 5

7. Raporte / 11

8. Të ndryshme /
36

Gjithsej 205

Dokumente të vërtetuara

dhe legalizim 167

Libri I Fakturave të regjistruara 1339

Drejtoria e Financave

1. Kërkesa 110
 2. Formular
aplikimi
për fëmijë të posalindur /
249
 3. Referenca / 37
 4. Vërtetime / 1
 5. Njoftime / 4
 6. Vendime / 14
 7. Regjistër / 9
 8. Ankesa / 10
 9. Raporte / 7
 10. Të ndryshme / 91
- Gjithsej 532**

Drejtori e Urbanizmit

1. Kërkesa / 174
2. Raporte / 50
3. Arsyeshmëria /

8

4. Njoftime / 9
5. Ankesa / 2
6. Të ndryshme 19

Gjithsej 262

Drejtoria e Gjeodezisë

1. Kërkesa / 97
 2. Përgjigje / 6
 3. Raporti i punës / 2
 4. Shkresa / 3
 5. Vërtetime / 1
 6. Dërgesa / 1
 7. Të ndryshme 10
- Gjithsej 120**

Inspektorati

1. Kërkesa / 31
2. Vendime / 55
3. Pëlqime / 11
4. Raporte /4
5. Urdhëresa / 3

6. Pëlqime / 11

7. Të ndryshme /
20

Gjithsej 135

**Drejtoria e
Bujqësisë**

1. Kërkesa / 1062

2. Kontrata / 4

3. Shpallje / 2

4. Të ndryshme 37

Gjithsej 1105

**Drejtoria e Shërbimeve
Publike**

1. Kërkesa / 41

2. Aplikimi për
banim social / 61

3. Vendime / 10

4. Raporte / 20

5. Të ndryshme /

34

Gjithsej 166

Emergjencat

1. Kërkesa / 24

2. Përgjigje /1

Gjithsej 25

Drejtoria e Arsimit

1. Kërkesa 227

2. Kërkesa aplikime për
bursa të studentëve / 232

3. Vendime / 132

4. Përgjigje / 200

5. Njoftime / 53

6. Raporte / 113

7. Vërtetime / 104

8. Të ndryshme / 394

Gjithsej 1455

**Drejtoria e
Kulturës**

1. Kërkesa / 40
2. Vendime / 1
3. Kontrata / 2
4. Raporte / 20
5. Specifikacione /
2
6. Thirrje Publike / 16
7. Aplikacione / 1
8. Projekte / 1
9. Ankesa / 6
10. Deklarata / 10
11. Procesverbale / 10
12. Të ndryshme 9

Gjithsej 120

**Drejtoria e
Shëndetësisë**

1. Raporte / 31
2. Kërkesa / 8
3. Listë / 1

Gjithsej: 41

**Raporti 6 (gjashtë)
muor 2021**

Periudha Janar /
Qershor

**Gjithsej 6487 lëndë janë
regjistruar në librat e protokolit.**

RAPORT I PUNËS SË ZYRËS SË IT-ve

Duke u bazuar në punët e Zyrës së TI-ve, në vazhdim po paraqes raportin e punëve të kryera gjatë periudhës kohore nga data **01.01.2021** deri me datën **01.06.2021**.

- | | | | |
|--|---|----|-------|
| 1. Resetim i passwordit të e-mail zyrtar | - | 26 | Raste |
| 2. Konfigurim i skanerit | - | 18 | Raste |

3.Instalim i printerëve	-	30	Raste
4.Probleme Hardwerike	-	19	Raste
5.Intervenime në rrjet	-	66	Raste
6.Formatim i kompjuterëve	-	25	Raste
7.Instalime të rrjetit	-	13	Raste
8.Intervenime në teren (QPS –QKMF)	-	8	Raste
9.Këshillime dhe trajnime të ndryshme	-	116	Raste
10.Qasje e re për e-mail zyrtar	-	6	Raste
11. Mbështetje e asamblesë komunale	-	4	Raste

Gjatë vitit 2021, zbatuam programet dhe politikat në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të të riatdhesuarëve*Rregullorja e re e QRK-ës, Nr.01/2018 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Riintegritit Rregullorë QRK Nr 22/2020 Per Riintegrimin e Personave te riathesuar. Rregullorë QRK – Nr. 01/2018 Per Kthimin te zhvendosur dhe zgjidhje te qendrueshme.

Duke ofruar ndihmën e paraparë në qasjen e barabartë të komuniteteve në shërbime publike, krijimin e kushteve për kthim dhe riintegrim të të zhvendosurve dhe të riatdhesuarëve.

Riatdhesimi:

Gjatë kësaj periudhe regjistruam nuk regjistruam te riatdhesuar (Sqarim: kjo shifër është marrë nga raportimet e Zyrës pritëse në ANP).

Nuk kemi te riatdhesuar nga komuniteti RAE.

1. Vështrim i përgjithshëm për komunitetet

Në komunën tonë, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 jetojnë, 37 (ose 0.06%) romë, 6 (ose 0.01%)ashkali, 1(ose 0.001) amerikan, 14 (ose 0.02%) te pa deklaruar.

Komunitete rom tdhe ashkali janë integruar në tërësi në përditshmërinë tonë.

Vërejtje

Vlenë të theksohet gjate vizitave që kemi bërë në teren, kemi parë se numri i komunitetit RAE është rritur nga 37 ne 50 te komunitetit rom dhe ashkali

Rom 36

Ashkali 14

Gjatë kësaj periudhe pandemike Komuna e Malishevës, ka ndihmuar familjet ne nevojë përmes shtabit emergjent komunal edhe familjet nga komuniteti RAE të cilat kanë kërkuar ndihmë me pako ushqimore dhe higjienike,

2. Projektet në terren për komunitete dhe përfituesit; bashkëpunimi me palët e interesuara – aktivitetet e ndërgjegjësimit publik

Për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas nuk ka ndonjë projekt të veçantë, pos PLV-ës që është një dokument obligativ. Si dhe rregullores QRK Nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme

Komunitetet në fjalë kanë pasur të shpeshtë në takime, tryeza të ndryshme brenda kësaj periudhe.

Së bashku me Komitetin për Komunitete dhe zyrtaren për barazi gjinore komunitetin RAE veçanërisht me gratë e komunitetit, kemi pasur një takim për dhunën në familje,

Takime çdo muaj ne Komitetin për Komunitete, Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.

Çështje tjera dhe aktivitete

Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur shumë aktivitete me të cilat u karakterizua edhe puna e ZKKK-ës. Pasi që është periudhe pandemike ZKK ishte aktiv në çështjes së kthimi dhe riatdhesimit, pastaj në informimin e drejtë të opinionit lidhur me mundësitë e Fondit për riatdhesim dhe riintegrim, vetëdijësimin e qytetarëve të riatdhesuar për të realizuar të drejtat e tyre, duke iu drejtuar institucioneve lokale dhe qendrore, adresimin korrekt për çështje civile etj.

Ky bashkëpunim u realizua me ndihmën e institucioneve qendrore (Departamenti i Riatdhesimit dhe i Riintegritit), pastaj ndihmën e pakontestueshme të OSBE-së (Zyra rajonale në Prizren, që ishte bartëse dhe organizatore e shumë takimeve dhe trajnimeve), UNHCR-it, si dhe të koordinators rajonal të MPB-ës.

Shumë nga detyrat dhe obligimet e ZKKK-ës nuk do realizoheshin në nivel të kënaqshëm pa mbështetjen logjistike dhe praktike të asociacioneve që u theksuan më lartë.

Në identifikimin e personave të dyshimtë rreth riatdhesimit, natyrisht se ndihmën e duhur më ofruan edhe përgjegjësit e Zyrës pritëse në ANP.

ARKIVA

- ❖ Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për certifikata të përvojës së punës në sektorë të ndryshëm, subjekte afariste, ndërmarrje shoqërore dhe private, njëkohësisht në bazë të kërkesave të palëve dhe në bazë të dokumentacionit me të cilin disponon Arkivi i KK-Malishevë janë lëshuar;
- ❖ Certifikata mbi përvojën e punës ;
- ❖ Vërtetime mbi përvojën e punës ;
- ❖ Vërtetim për kryerjen e shërbimit ushtarak në ish - APJ-së ;
- ❖ Deklaratë me dëshmitarë mbi përvojën e punës ;
- ❖ Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për qasje në dokumente arkivore ;
- ❖ Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për dokumente të identifikimit ;
- ❖ Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për dokumentacion ;
- ❖ Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave mujore nga njëmbëdhjetë (11) zyrat e ofiqarisë për dokumentacion në sektorin e Demografisë dhe Statistikës, si dhe dorëzimi i dokumentacionit në “Agjencionin e Statistikave në Prizren ;
- ❖ Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për: Aktvendime, Vërtetime, dosje në LAL, LAM dhe LAV dhe regjistrime të ndryshme ;
- ❖ Në Arkiv janë në proces e sipër për t’u pranuar edhe dokumentacione të tjera sipas procedurave arkivore ;
- ❖ Sistemimi dhe risistemimi i lëndëve arkivore gjithashtu sipas procedurave arkivore;

Drejtoria për Arsim dhe Edukim

Bazuar në punën e realizuar gjatë gjashtë muorit të parë të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim u njoftojmë në përmbajtje të shkurtër që Drejtoria ka realizuar këto projekte:

- Realizimi i kontratës për furnizim me material higjenik;
- Ka vazhduar projekti dyvjeçar për renovimin e shkollave;
- Në realizim projekti: Rregullimi i fushës së sportit në Bubavec dhe Shkozë duke u realizuar fushat sportive në disa shkolla: Imer Krasniqi në Carrallukë, "Afrim Buçaj" në Lladroc, "Afrim Krasniqi" në Bardh, "Kajtaç Ramadani" Paralelja-Gullboc,
- Vazhdimi i realizimi i projekteve : Ndërtimi i shkollave në Malishevë dhe Dragobil e financim nga MASHT-i
- Në Realizim kontrata :Mirëmbajtja e nyjeve sanitare;
- Realizimi i kontratës për mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore;
- Renovimi i kulmit të ShFMU" Imer Krasniqi" në Carrallukë;
- Vazhdon Ndërtimi i Çerdhes së Fëmijëve në Malishevë dhe në Kijevë;
- Realizimi i Testit PISA, të Arritshmërisë, dhe Testit PIRLS;
- Përgatitja për realizimin e Testit të Maturës për datën 26 qershor 2021;
- Vazhdim i Furnizimit të shkollave me material teknik sipas kontratës për furnizim me material teknik;
- Përrurimi i objektit të ShFMU" Habib Berisha" në Gurbardh dhe përfundimi i kontratës për furnizim me inventar për këtë institucion komunal me vetfinancim nga komuna e jonë.

- Përrurimi i Sallës së Sportit në SHFMU" Ibrahim Mazreku" në Malishevë.
- Fillimi i projektit: Ndërtimi i Aneksit të SHFMU" Ruzhdi Xhyliqi" në Marali;
- Përgatitja e projekteve të tjera në bashkëpunim me MASHT-in dhe donatorë tjerë;
- Bashkëpunimi me donatorë të Arsimit si CARITAS, Biblioteka Kombëtare e Kosovës etj.
- Shpallja e konkursit për ndarjen e më shumë se 200 bursave shkollore
- Në realizim transporti i nxënësve nga Lagja Garaqevë për tek SHFMU" Asim Vokshi" në Panorc dhe anasjelltas
- Në realizim transporti i nxënësve nga fshati Janqist dhe Lagjet periferike të fshatit Shkozë për në SHFMU" Salih Bytyçi" në fshatin Shkozë
- Në realizim transporti i nxënësve nga lagja e Muhaxherëve për tek SHFMU" Hasan Prishtina" në Tërpezë dhe anasjelltas;
- Në realizim transporti i nxënësve nga Lagjet e fshatit Ngucat për në SHFMU" Dëshmorët e Kombit" në Ngucat dhe anasjelltas;
- Realizimi i kontratës për furnizimin me pajisje dhe mjete konkretizimi për katër klasë të parafillorëve dhe realizimi i trajnimit për mësueset edukatore të nivelit parafillor në: Malishevë, Turjakë, Carrallukë, Bellanicë.
- Realizimi i kontratës për mirënjohje të kontributit të mësimdhënësve pensionistë në vitin 2021;
- Realizimi i shumë projekteve shkollore në rregullimin e hapësirave të gjelbërta në oborret shkollore me përkrahje edhe nga komuniteti shkollor;
- Pranimi i disa donacioneve në pajisje të teknologjisë informatike- laptop- kompjuterë-printerë, fotokopje dhe mjete të tjera për shkollat;
- Në realizim kontrata për furnizim me shujtë ushqimore për nxënësit parafillor dhe fillor;
- Realizimi i transportit për nxënësit me nevoja të veçanta;
- Shqyrtimi i afër dy mijëra kërkesave për palë të ndryshme nga DKA dhe palë të tjera.
- Gjatë këtyre muajve është zhvilluar mësimi sipas udhëzimeve të MASHT-it, ku janë zhvilluar programet mësimore sipas programit mësimor të modifikuar nga udhëzimet e MASHT-t dhe në respektim të masave të përcaktuara nga ISHP-ja dhe MSH e MASHT-i DKA-ja ka mbajtur kontaktet e rregullta me Institucionet Kompetente për të monitoruar punën e institucioneve arsimore dhe për të raportuar për të gjitha ecuritë e punës në institucionet arsimore komunale dhe qendrore. Gjithashtu DKA ka bashkëpunuar ngushtë me Drejtoritë tjera komunale dhe Institucionet tjera komunale për të ruajtur funksionimin e punës institucionale.

Drejtoria për Urbanizëm

Drejtoria e Urbanizmit, duke u mbështetur në fushëveprimtarinë e vet dhe planin e punës për vitin 2021, angazhimet e veta i ka fokusuar në realizimin e projekteve kapitale nga viti 2020 (projektet dyvjeçare) dhe përgatitjen e materialeve, paramasave dhe parallogarive, për projektet e vitit 2021 në lëmin e infrastrukturën publike.

Për vitin 2021 janë planifikuar projekte të infrastrukturës publike:

- Ndërtimi-Asfaltimi i 37.18 km rrugë lokale,
 - Ndërtimi i 46.78 km kanalizimeve të ujërave të zeza,
 - Ndërtimi i trotuareve në gjatësi 22.99 km ,
 - 2 objekte të shkollave fillore dhe renovimi në Malishevë,
 - Ndërtimi i këndeve të lojërave për fëmijë në njëzet fshatra
 - Ndërtimi i 2 fusha sportive në Balincë/Guriq dhe zhveshtoret
 - Ndriçimi publik në tridhjetetë fshatra, afër 614 tuba-poqa
 - Renovimi objekteve shkollore në Carrallukë dhe Drenoc
 - Ndërtimi i rrugeve bujqësore 8.86 km
 - Ndërtimi i garazhave të QKMF-së
 - Ndërtimi i aneksit të Çerdhes (aneks) në Malishevë dhe ndërtimi i çerdhes në fshatin Kijevë
 - Mirëmbajtja verore e rrugëve urbane dhe lokale
 - Rregullimi i oborrit në shkollën fillore fshatin Astrazup
 - Rregullimi i oborreve të shkollave fillore në fshatrat; Bubavec, Llazicë, Mleqan, Kijevë, Senik, Kravasari dhe Malishevë
 - Ndërtimi i serave bujqësore për fermerë.
- Mbikëqyrjen e punimeve në kontratat (projektet kapitale) të vitit të kaluar dhe këtij viti, projekte dy vjeçare 2020/2021-të në rrugët e fshatrave: Bellanicë, Ngucat, Drenoc, Bubël, Astrazup, Balincë, Turjakë, Burim, Carrallukë, Terpezë, Lladrovc, ku janë në përfundim e sipër, ndërsa rrugët e fshatrave; Kravasari, Guriq, Shkozë, Marali, Pagarushë, Bubavec, Panorc, Mleqan, Gollubovc, Turjakë, Llazicë, Llapçevë , Lladrovc, Fshati i Ri, Terpezë e Poshtme, Burim, Mirushë, Maxharrë, Gurbardh, Astrazup dhe Carrallukë, janë duke u punuar dhe në realizim e sipër. Vlenë të përmendet realizimi i punimeve në të dy anët e lumit Mirusha, nga qendra e qytetit deri tek mini tanziti.
- Dalja në teren dhe përgatitja e paramasave për ndërtimin e kanalizime të ujërave të zeza në fshatrat: Astrazup, Balincë, Banjë, Bardh, Bellanicë, Bubavec, Bubël, Burim, Carrallukë, Damanek, Dragobil, Drenovc, Fshati i Ri, Gollubovc, Gurbardh, Guriq, Janqist, Kravasari, Kijevë, Lumnishtë, Lladrovc, Llapçevë, Llazicë, Maxharrë, Mirushë, Mleqan, Ngucat , Pagarushë, Panorc, Plloqicë, Senik, Stapanica, Shkarashnik, Shkozë, Temeqinë, Tërpezë, Turjakë, Vermicë dhe Malishevë, ku janë përgatitur për tenderim dhe priten të publikohen. Projekt tjetër është edhe kolektori kryesor i ujërave të zeza, renovimi nga fshati Bellanicë-Bubel.
- Dalja në terren dhe përgatitja e paramasave dhe parallogarive për ndërtimin e ndriçimit publik në fshatrat ; Astrazup, Balincë, Banjë, Bellanicë, Bubave, Burim, Carrallukë,

Gurbardh, Dragobil, Drenoc, Fshati i Ri, Gajrak, Guriq, Janqist, Kijevë, Llapçevë, Llazicë, Malishevë, Marali, Mleqan, Ngucat, Pagarushë, Panorc, Plloqicë, Senik, Stapanicë, Shkozë, Temeqinë, Terpezë, Terpezë e Poshtme, Turjakë dhe Vërmicë , ku janë pregadit paramasa dhe pritët të tenderohet si dhe projekti i mirëmbajtjes ku si projekt është duke u realizuar.

- Gjatë kësaj periudhe një pjesë e stafit është marrë me pregaditjen e materialit të draft Planit Zhvillimor Komunal (2017-2025) ku si projekt për hartat zonale ku deri më tani janë mbajtur disa takime dhe janë shtjelluar shumë tema me interes për teritorin e Komunes sonë është duke vazhduar që brenda këtij viti të konkretizohet si projekt ku është duke u financuar nga ana e GIZ-it Gjerman dhe Kuvendit Komunal. Ndërtimi i sistemit të ujitjes në fshatin Janqist projekt i financuar nga SDC-ja dhe Hidroregjioni Jugor , ndërtimi i objektit të shkollës fillore në Malishevë (lagjia Matosh) ku është duke u punuar në fshatin Dragobil është në ndërtim e sipër si dhe ndërtimi i objektit të inkubatorit për bizneset private në Malishevë.
- Dalja në teren dhe vizita në shikimin e lokacioneve për ndërtimin e fushave sportive në lokacionet e objekteve të shollave fillore në fshatrat; Balincë dhe Guriq si dhe projekti i rregullimit të oborreve të shkollave fillore në fshatrat; Bubavec, Llazicë, Kijevë, Llapçevë, Mleqan, Senik, dhe Malishevë , dy të parat në tenderim dhe tjera janë në fazën e realizimit. Vazhdimi i punimeve në fushat sportive në fshatin Bubavec dhe Shkozë dhe punimi i zhveshtoreve dhe tribunave në stadiumin e Qytetit.
- Një pjesë e stafit ka përgatitur paramasat e ndërtimit të serave bujqësore për fermeret e komunës sonë ku si projekt është në fazën e tenderimit. Projekt tjetër është edhe renovimi i lapidarve në fshatin Balincë dhe Gurbardh, si dhe renovimi i urës në fshatin Bubël ku është në përfundim e sipër. Ndërtimi i shtallave për fermer në fshatrat Astrazup, Gurbardh dhe Mirushë.
- Një pjesë e punëtorëve është marrë me pregatitjen dhe ekzekutimin e paramasave për ndërtimin e trotuareve në fshatrat; Turjakë, Carrallukë, Gurbardh, Gajarak, Kërvasari, Lladrovë, Vermicë, Mleqan, Kijevë, Terpezë, Lumnishtë, Pagarushë, Shkozë, Bardh, Senik, Astrazup dhe Malishevë. Ndërtimi i trotuarit Malishevë-Dragobil dhe në rrugën “Imer Krasniqi” në Malishevë, ku për momentin janë në fazën e tenderimit, ndërsa ndërtimi i trotuarit në fshatrat e lartpërmendur është në përfundim e sipër.
- Në drejtorin e Urbanizimit gjatë periudhës Janar-Qershor janë parashtruar gjithsejtë 167 kërkesa, ku 69 kërkesa janë realizuar (leje ndërtimore, kushte urbanistike, vërtetime, pëlqime) dhe 98 kërkesa janë në shqyrtim. Të hyra financiare në drejtori gjatë këtij viti janë në vlerë prej 51,250.15 €.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

1. Mirëmbajtje të hapësirave të gjelbra dhe grumbullimi i mbeturinave(kontratë kornizë me Ekoregjonin) për vitet prill-2021 deri mars-2023 .
2. Dekorimi i qytetit për ditët festive shtetërore dhe kombëtare në afat prej 2 viteve .
3. Mirëmbajtje të ndriçimit publik në afat prej 2 viteve 2020-2021.
4. Shërbimet e varrimit për qytetarët e KK-Malishevë për vitet 2021 dhe 2022 .
5. Mirëmbajtje dhe deblokim të kanalizimeve për vendbanimet që nuk janë në menaxhimin e Hidroregjonit (kontratë me Hidroregjonin) .
6. Shërbimet e automerimangës inicimi i procedurës në prokurim .
7. Financimi dhe përzgjedhja e 5 familjeve në mes të MCC- Fondit të Mijëvjeçarit të Kosovës (MFK) dhe komunës për programin e përbashkët të shtëpive (HER) për EE si raste sociale me pjesëmarrje financimi **80%-MFK dhe 20%-KK-Malishevë** .
8. Në kuadër të efijencesë për energji kemi dhënë ndihmesën tonë teknike dhe profesionale në arritjen e financimit të EE për 3 projekte publike të KK-Malishevë në FKEE për vitin 2021.
9. Vijat urbane për transportin publik në vendbanimet e KK-Malishevë.
10. Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Qeverinë Japoneze (JICA) për projektin “Rritja e kapacitetit për menaxhimin e mbeturinave drejtë shoqërisë së shëndoshë me cikël të materialit” faza e dytë. Projekti parashihet të jetë 3 (tre) vite.
11. Shpallja e konkursit për banim social në objektin e banimit social 02 me 44-njësi banesore në Malishevë.
12. Në kuadër të efijencës për energji kemi dhënë ndihmesën tonë teknike dhe profesionale në arritjen e financimit nga AKEE dhe komunës në vlerë prej 110 mijë euro në implemtim të pilot projektit “Promovimi i Efijencës së Energjisë në nivel lokal përmes zbatimit të masave të EE” sipas ndarjes financiare 80% -AKEE dhe 20%-KK-Malishevë.

Drejtorja e Inspektoratit

Drejtorja e Inspektoratit edhe në këtë gjashtë mujorë ka bërë inspektime të vazhdueshme në të gjithë sektorët, në veqanti për zbatimin e masave mbrojtëse COVID-19. Gjatë kësaj periudhe kemi bashkëpunuar në inspektime me Inspektoret e AUV-Regjional për zbatimin e masave Covid-19.

Inspektorët në përgjithësi gjatë punës kanë dhënë vërejtje gojore, si dhe me shkrim të natyrave të ndryshme.

Jemi marrë me shqyrtimin e Ankesave dhe Kërkesave të ndryshme të parashtuara nga qytetarët dhe nga subjektet afariste.

Edhe këtë vit në bashkëpunim me GIZ –in gjerman kemi evidentuar pikat e mbeturinave ilegale në gjithë territorin e Komunës së Malishevës.

Gjithashtu edhe në këtë kohë të raportimit kemi pas shumë raste të bllokimit të kanalizimit në shumë vende, me këtë rast në bashkëpunim me kompaninë publike Hidro-Regjioni Jugor në Malishevë kemi bërë deblokimin e kanalizimeve.

Kemi kontrolluar mallrat ushqimore për afat të skadimit, si dhe nëse janë të dëmtuara dhe nuk i plotësojnë kushtet për treg. Me këtë rast kemi asgjësuar mall të dëmtuar në vlerën mbi 51,000 euro. Gjithashtu me rastin e dëmtimit të maskave shëndetësore (Myfixmask) në Fabrikën e Maskave “ELIS” SHPK në fsh.Bellanicë, kemi bërë asgjësimin e sasisë 41,400 copë.

Janë kontrolluar të gjitha subjektet afariste për pastërtinë e përgjithshme të tyre dhe janë dhënë urdhëresa që të bëjnë Dezinfektimin e lokaleve ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Janë kontrolluar të gjitha shkollat SHMU dhe SHML në Komunën e Malishevës për mirëmbajtjen e pastërtisë, si dhe a janë duke i respektuar të gjitha masat mbrojtëse ndaj Covid-19.

Kemi inspektuar terrenin në përgjithësi dhe njëkohësisht kemi bërë edhe vërejtje për mos hedhje të ujërave të zeza, plehrave të shtallave dhe mbeturinave në pronat publike nga qytetarët.

Janë inspektuar të gjithë Gurthyesit për shkak të monitorimit të tyre për ndotje të ambientit.

Është bërë mbikëqyrja e transportit urban, janë kontrolluar AutoTaxit, dhe gjithashtu jemi duke bërë në vazhdimësi ndalimin e veprimtarisë të Taxive dhe KombiTaxive ilegal.

Kemi bërë luftimin e informalitetit në përgjithësi, kemi inspektuar të gjitha subjektet afariste, kemi bërë inspektime të gjitha tregjeve.

Kemi inspektuar ndërtimet e objekteve në përgjithësi dhe kemi parandaluar ndërtimet pa leje ndërtimore.

Është bërë ndalimi i therjes së kafshëve në ambiente të hapura, si dhe shitja e shpezëve pas fillimit të përhapjes së sëmundjes së shpezëve.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Gjatë këtij gjashtë mujori kemi realizuar këto projekte dhe aktivitete të planifikuara në planin vjetor:

- Shërbime të realizuara në Janar – Qershor : 110527 , në QKMF/QMF/AMF

- Gjendja e përgjithshme me covid-19 në Komunën e Malishevës, është kjo: Nga fillimi i pandemisë e deri më tani me covid-19 janë regjistruar 1125 raste, prej tyre 1072 janë shëruar, 52 kanë vdekur dhe aktiv me covid është 1 rast.
- Ne periudhën Janar – Qeshor janë regjistruar 576
- Kemi filluar procedurat : për material laboratorik
- Kemi filluar procedurat për pajisje mjekësore
- Jemi në procedura për material stomatologjik
- Kemi realizuar kërkesën e QKMF-së për furnizim me Autoambulancë në vlerë prej 40,00.00 € është nënshkruare kontrata.
- Masë tjetër në parandalimin dhe luftimin e etheve hemorragjike që është ndërmarrë, është aktiviteti i dezinfektimi selektiv. Mjetet financiare nga Komuna e Malishevës.
- Raste të pickuara nga rriqrat 678 (deri në momentin e raportimit).

Kemi ndihmuar 180 familje në bashkëpunim me UNDP në vlerë nga 70 € për periudhën 6 Mujore.

-

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Spektori i kulturës

Spektori i kulturës përkatësisht zyrtari për kulturë në kuadër të Drejtorisë oragnizon aktivitetet kulturore për shënimin e datave të rëndësishme historike për vendin tonë dhe poshtu aktivitete të tjera kulturore me qëllim të pasurimit të jetës kulturore në komunën tonë.

Aktivitetet kulturore të realizuara në vitin 2021:

- Flakës së Janarit - janë vënë kurora lulesh te vendi i rënies së martirëve Hysni Mazreku dhe Ali Kryeziu .
- Shënimi i përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës me këtë rast është mbajtur mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Malishevës, më pas në mënyrë të organizuar janë bërë homazhe dhe janë vendosur buqeta me lule te Shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari në Malishevë, vizitë në varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe në Kleçkë.
- Në kuadër të shënimit të manifestimit “Epopeja e UÇK-së”, aktivitetet kanë filluar me seancë solemne më pas janë bërë nderime pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në Malishevë, homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe në Prekaz.

- Me 15 maj, është bërë hapja zyrtare e themelimit të SHKA “Oda e Kijevës” me ç’rast është shfaqur edhe një program kulturo-artistik në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë.
- Për nder të shënimit të 16 Qershorit -Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Malishevës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, me 8 qershor, ka shpall konkursin artistik për krijime letrare, artin pamor dhe artin muzikor.
- Kremtimi i Ditës së Çlirimit dhe e Dëshmorëve të Malishevës është shënuar me aktivitete të shumta kulturore, si:
- Ekspozitë artistike dhe publikimi i rezultateve të konkursit në lëmin e pikturës është organizuar në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë. Në këtë ekspozitë morën pjesë 13 Artistë të artit (pikturë), komisioni vlerësues i përbërë prej 3 anëtarëve vendosi që :
 - Vendi i parë 300 €: Jetmir Morina;
 - Vendi i dytë 200 € : Hajrush Fazliut, i cili çmimin e dhurojë për një fëmijë me nevoja të veçanta;
 - Vendi i tretë 100 € : Granit Aliu, po ashtu gjysmën e çmimit e dhuroi për bamirësi.
- Orë letrare dhe publikimi i rezultateve dhe ndarja e çmimeve të konkursit artistik në lëmin e krijimeve letrare, në këtë konkurs kanë konkurruar 49 krijues letrar, komisioni vlerësues i përbërë prej 3 anëtarëve ka vendosur që:
 - Poezia “ Tri varret e dëshmorit të zhdukur”, me shifrën: “ Ndër të gjallët” të jetë fituese e vendit të parë 150 €,
 - Poezia “ Si në balada”, me shifrën: “ Gur i degdisur të jetë fituese e vendit të dytë 100€,
 - Poezia “ Kohë e ligë”, me shifrën: “ 1992” të jetë fituese e vendit të tretë 50 €.
- Në konkursi artistik në lëminë e muzikës kanë konkurruar gjithsej 10 këngë, komisioni vlerësues ka dëgjuar dhe vlerësuar me kujdes secilën këngë dhe duke vendosur si bazë për vlersim interpretimin e bukur, tekstin, melodinë, aranzhimin ka arritur në këtë përfundim:
 - Vendi i parë 150 €: Valbona Krasniqi me këngën “Këngë për Feriz Krasniqin”
 - Vendi i dytë 100 €: Teuta Krasniqi me këngën “Moj Kosovë lum na për ty”
 - Vendi i tretë 50 €: Të bijtë e Bajram Bajës me këngën kushtuar dëshmorit “Kujtim Krasniqi”.
- Program kulturor artistik me këngë dhe valle në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë.
- Më pas në mënyrë të organizuar janë bërë homazhe dhe janë vendosur buqeta me lule te Shtatorja e Komandantit Legjendar “Adem Jashari”, vizitë të varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë.
-

Sektori i rinisë

përkatësisht zyrtari për rini në kuadër të Drejtorisë në bashkëpunim me organizatat rinore të komunës sonë organizon aktivitete të ndryshme që në fokus kanë rininë.

- Gjatë muajit janar, është hartuar plani i punës për periudhën janar-dhjetor 2021, në përputhje me Planin e Veprimit Rinor Lokal 2021-2023.
- Jam trajnuar për Diplomaci, komunikim, protokoll dhe etiketë.
- Kam vizituar Qendrën e Rinisë dhe jam njohur nga afër për gjendjen e krijuar aty nga vërshimet. Qendra e rinisë është vërshuar nga të reshurat e mëdha atmosferike dhe si pasojë, nuk ka kushte për zhvillimin e aktiviteteve në këtë objekt.
- Kemi realizuar kërkesën e kryetarit të Qendrës Rinore për transferimin e Qendrës Rinore përkohësisht në objektin e Shtëpisë së Kulturës “Tahir Sinani”.
- Jam trajnuar për komunikim me publikun dhe prezantime publike.
- Dy herë gjatë këtij muaji e kam vizituar Qendrën Rinore në Malishevë. Në të dy herat, QRM, ka qenë e mbyllur. QRM, është e licencuar nga komuna dhe e njëjta ka orar të punës.
- Në kuadër të shënimit të 16 Qershorit- Dita e Çlirimit dhe e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, kam organizuar orë letrare në të cilën janë shpall edhe rezultatet e konkursit artistik të shpallur nga DKRS.
- Kam marr pjesë në punëtorinë e organizuar për performancë komunale të organizuar nga DEMOS-i nëpërmjet MAPL-së. Në këtë punëtori, janë diskutuar sfidat, mangësitë dhe problemet lidhur me transparencën komunale.
-
- **Spektori i sportit**
- Në muajin Janar kam bërë hartimin e planit vjetor për vitin 2021 për aktivitetet të cilat do t'i zhvillojmë në sektorin e sportit gjatë kësaj periudhe.
Gjatë këtij muaji së bashku me drejtorin kemi vizituar Stadiumin e qytetit “Liman Gegaj” si dhe palestrën e qytetit “Habib Zogaj” ku u njoftuam nga punëtorët e këtyre institucioneve lidhur me aktivitetet të cilat zhvillohen në këto terrene sportive.
- Në muajin shkurt për nder të shënimit të 13-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës janë organizuar turne Sportiv në: Volejboll, Shah dhe një lojë miqësore në Futboll.
- Më datë 13.02.2021, së bashku me Klubin e Volejbollit Malisheva, është organizuar turniri në Volejboll, për nder të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
Turniri organizua në shkollën "17 Shkurti" në Banjë të Malishevës ku pjesëmarrës ishin këto klubet :
1. "KV MALISHEVA"- Malishevë

2. "KV FERONIKELI" -Drenas
3. "KV GJINOFCI"- Suharekë
4. "KV KAÇANIKU"- Kaçanik

Fitues në këtë Turnir:

Vendi i parë--- "Kv Malisheva"

Vendi i dytë--- "Kv Gjinofci"

Vendi i tretë--- "Kv Drenasi"

Fituesit në fund u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje.

- Gjithashtu me datën 13.02.2021 është organizuar turniri në shah ku pjesëmarrës ishin 10 garues, fitues të këtij turniri ishin:

1. Ismet Mazreku
2. Lutfi Gashi
3. Haki Kryeziu

Fituesit në fund u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje.

- Po ashtu me datën 17.02.2021 është zhvilluar edhe një lojë miqësore në futboll për vajza me gjenerata U16 ndërmjet klubit KFF Shqiponja - KFF Presheva.
- Të gjitha këto aktivitete janë zhvilluar për nder të 17 Shkurtit ditës së shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.
- Gjatë muajit maj në Palestren sportive "Habib Zogaj", në Malishevë janë Organizuar garat shkollore në futsall nga Shoqata e Pedagogëve të sportit shkollor në Malishevë, për të gjitha SHFMU-t e komunës së Malishevës, ku vendin parë për meshkuj e fituan SHFMU "Ibrahim Mazreku", ndërsa për femra SHFMU "Habib Berisha".
- Në finalet dhe shpërndarjen e shpërblimeve, ishin të pranishëm edhe nënkryetari i komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Mazrreku dhe drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, të cilët uruan shkollat pjesmarrëse në këto gara dhe fituesit.
- Gjatë kësaj periudhe FC "Malisheva" në futboll arriti të bëhet kampion i ligës së parë, grupi A dhe të siguroj hyrjen në super ligën e futbollit të Kosovës, institucionet komunale nën patronatin e nënkryetarit të komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, dhe drejtorit të DKRS-së Rexhep Mazrreku organizuan pritje përgëzuese për FC "Malisheva".
- Në majin mars, kanë vazhduar punimet në ndërtimin e zhveshtoreve dhe tribunave në Stadiumin e Qytetit "Liman Gegaj" në Malishevë.
- Klubi i Futbollit për Femra, KFF "Malisheva" në kategorinë U-16, e kanë mbrojtur titullin e kampionit të Kosovës, në këtë kategori të garave, dhe për këtë qëllim, së bashku me nënkryetarin e komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Mazrreku, kemi organizuar një pritje për këtë ekip

futbolli, për t'i uruar për titullin dhe për t'i falënderuar për paraqitjen e jashtëzakonshme në kampionat.

- Gjatë këtij muaji për nder të 16 Qershorit- Ditës së çlirimit dhe Dëshmorëve është organizuar turnir tradicional “Ibrahim Mazreku” në Futboll në Palestrën sportive “Habib Zogaj” në Malishevë.

Turniri ka filluar me datën 13.06.2021, në orën 18:00, ku pjesëmarrës ishin 11 ekipe. Finalja e turnirit është zhvilluar më datë 15.06.2021 ndërmjet ekipeve KF “Ibrahim Mazreku” nga Malisheva dhe KF “Trasing Grup” nga Drenasi dhe në fund fitues dolën:

1. KF Trasing Grup nga Drenasi i cili u shpërblye me 500 €, kupë dhe mirënjohje
 2. KF Ibrahim Mazreku nga Malisheva i cili u shpërblye me 300 €, kupë dhe mirënjohje
 3. KF Rahoveci nga Rahoveci i cili u shpërblye me 100 €, kupë dhe mirënjohje.
- Me këtë rast u shpërblye edhe lojtari më i mirë i cili ishte Shpend Brahimi si dhe portjeri më i mirë Fidan Misini.
Prezent në këtë aktivitet ishin edhe nënkryetari i komunës z.Hajdin Berisha dhe Drejtori i DKRS-së Rexhep Mazrreku.

Në muajin maj është bërë shpallja e Thirrjes Publike për subvencionimin e OJQ-ve, sipas Rregullores MF 04/2017.

Shuma financiare për subvencione këtë vit ka qenë 55,000.00 €. Në këtë thirrje publike janë subvencionuar 25 OJQ.

Përfundim

(Shumë aktivitete tjera Kulturore Rinore dhe Sportive, që janë planifikuar të realizohen sipas planit të punës, ka qenë e pamundur të realizohen për shkak të gjendjes së krijuar me pandeminë COVID-19)

Njësia e Komunikimit Publik

Gjatë periudhës janar- qershor të vitit 2021, janë zhvilluar 1990 aktivitete të ndryshme, ku përfshihen përcjellja e aktiviteteve të kryetarit, drejtorëve komunal dhe zyrtarëve tjerë. Prej këtyre aktiviteteve, janë aktivitete të kryetarit dhe qeverisë komunale, ku përfshihen takimet në zyrat përkatëse, vizita në terren, takime me qytetarë dhe të tjera, ku janë **bërë 289 lajme, 109 njoftime, shpallje dhe konkurse 40, 6 buletin (Janar- qershor 2021), si dhe janë publikuar dokumente ku përfshihen, 9 kontratat, 22 plane pune dhe raporte pune, 1 Rregullore, dhe 132 vendime të kryetarit, 44 vendime të Kuvendit të Komunës, 12 procesverbale të KK, mbledhje të kuvendit, 6 të rregullta, 1 solemne, 3 të jashtëzakonshme ,2 urgjente, 5 procesverbale të Komitetit për Politikë, mbledhje të rregullta 3 të jashtëzakonshme ,3**

konsultime publike, 1 Takim Publik , në mënyrë elektronike do ti pranojmë pyetjet e qytetarëve dhe përgjigjemi poashtu. Dëgjimet KAB-it 2022/2024, publike të kryetarit, kurse, drejtorisë për buxhet dhe financa, rregulloreve me pjesëmarrje të grupeve të interesuara, 11kërkesa në Qasjen për Dokumente Publike, prononcime publike për medie nga zyrtari për informim, e po ashtu edhe nga kryetari i komunës, aktivitete të komiteteve, dhe komisioneve janë përcjellë, aktivitete tjera, si monitorim i situatës me covid-19, vizita në terren, takime zyrtare dhe të tjera. Të Enjëten, pritja e palëve nuk ka vazhduar për arsye të pandemisë me covid -19. Në këtë raport nuk janë përfshirë deklaratimet për medie dhe reagimet e ndryshme që i ka bërë Zyra për Informim.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Me rastin e paraqitjes së rastit të parë me virusin COVID-19 në Komunën e Malishevës, me datë 12.03.2020, në ora 22:00, me vendim të Kryetarit të Komunës, sipas vendimit të Qeverisë së R. të Kosovës për aktivizimin e Planit të Reagimit Kombëtar, aktivizohet edhe Plani i Reagimit për komunën e Malishevës, në kuadër të sëcilit edhe aktivizohet Komiteti Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Shtabi Komunal Emergjent për luftimin e Pandemisë COVID-19.

Me Komitetin Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim ka udhëheqë Kryetari i Komunës konform Planit të Reagimit, dhe se i njëjti ka mbajtur gjithsej katër(4) takime dhe në përbërje të plotë.

Ndërsa, me Shtabin Komunal Emergjent ka udhëheqë Drejtori i Drejtorisë për SH dhe MS, kurse Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim kishte funksionin mbështetës.

Në kuadër të funksionit të saj Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim sipas Planit të Reagimit, ka ngrit nivelin e gatishmërisë së personelit dhe ekipeve për reagim SHEM (**Shërbimit Emergjent Medicinal**), NjPZSH, PTK, KEDS, EKOREGJIONI dhe HIDROREGJIONI duke menaxhuar dhe koordinuar.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, është aktivizuar dhe ka funksionuar Qendra Operative Emergjente Lokale – QOEL, si nyje e komunikimit, informimit dhe alarmimit brenda Komunës dhe me Institucionet qendrore, dhe e cila ka funksionuar pa ndërprerje.

DKMSH gjatë kësaj periudhe ka caktuar depot e Kryqit të Kuqë të Kosovës- dega në Malishevë, SHHBK “Nëna TEREZE” në Malishevë dhe mobilizimin e një depo private për grumbullimin dhe shpërndarjen e gjërave ushqimore dhe higjienike dhe miell për popullatën e Komunës së Malishevës

Identifikimi i familjeve nevojtare është bere ne koordinim me kryetarët e fshatrave dhe shoqatave humanitare, të gjitha donacionet qe kane ardhur janë pranuar nga Shtabi Komunal Emergjent.

Vlenë të theksohet se gjatë kësaj periudhe kemi pasur një numër të konsiderueshëm të donacioneve, si nga organizatat e ndryshme humanitare por edhe nga bizneset dhe personat fizik, dhe këto donacione kanë qenë një ndihmë për Shtabin Komunal qe sa do pak është arrit të plotësohen kërkesat për gjera ushqimore për familjet nevojtare.

Lista e donacioneve qe janë pranuar nga Shtabi Emergjent Komunal prej paraqitjes së pandemisë COVID-19 deri me tani është:

1. Halim Hoti-Carralluke Suedi – Shoqata “ NDIHMO EDHE TI “ **100** Pako ushqimore.
2. Halil Kastrati - Shoqata “ JETIMAT E BALLKANIT “ **100** Pako Ushqimore dhe Higjienike dhe **2500** kg. miell
3. Elvis Naqi – Shoqata “ DUART E BËMIRËSISË “ **20** Pako Ushqimore dhe Higjienike
4. Bashkësia Islame me seli në Malishevë **10** Pako Ushqimore dhe Higjienike
5. Donacioni ; OKB UNMIK, Mr. Lino Sciara **120** Pako Ushqimore dhe Higjienike

Me anë të këtyre donacioneve kemi përkrahur mbi **2,000** familje nevojtare, të gjitha listat e përfituesve të këtyre familjeve përveç qe i posedon Shtabi Emergjent Komunal i posedojnë edhe kryetarët e fshatrave secili për fshatin e vete, gjithashtu çdo donatori që ka kërkuar të ketë listën e donacionit që ka dorëzuar, ja kemi percjellë listën e përfituesve të donacionit.

Furnizimi me gjera ushqimore , higjienike për familjet skamnore gjatë situatës me COVID-19

Nr.	Fshati	Numri i familjeve	Vërejtje:
1	Astrazub	58	
2	Banjë	103	
3	Bellanicë	58	
4	Lladraviq	52	
5	Burim	37	
6	Berishë	22	
7	Bubël	19	
8	Bubavec	62	
9	Balincë	43	
10	Carrallukë	97	
11	Drenoc	90	
12	Dragobil	40	
13	Gurbardhë	43	

14	Golluboc	27	
15	Gajrak	20	
16	Gurishtë	37	
17	Mirushë	31	
18	Marali	40	
19	Maxharë	19	
20	Malishevë	200	
21	Mleqan	43	
22	Panorc	35	
23	Llapqevë	21	
24	Kijevë	40	
25	Plloqic e Ep.	29	
26	Vërmicë	45	
27	Stapanicë	21	
28	Rud	15	
29	Llazicë	52	
30	Shakarashnik	39	
31	Qypevë	17	
32	Turjakë	50	
33	Lumnishtë	40	
34	Damanek	45	
35	Plloqic e Ul.	24	
36	Ngucat	53	
37	Shkozë	44	
38	Kërvasari	44	
39	Janqisht	24	
40	Pagarushë	44	
41	Terpez e Ul.	26	
42	Fshati i Ri	28	
43	Terpezë	57	
44	Lladroc	60	
45	Temeqinë	40	
46	Senik	53	
Gjithsej		2083	

Për të menaxhuar në mënyrë sa ma efikase me Situatën Pandemike COVID-19, në mbrojtje të shëndetit të popullatës, DKMSH-ja ka bërë edhe kërkesa për lejimin e mjeteve financiare dhe ato për:

- Furnizim me miell në vlerë prej20.000 €,
- Furnizim me gjëra Ushqimore dhe Higjienike40,000 €,

Furnizim me miell për nevojat e familjeve nevojtare ka qenë kërkesë e Shtabit Emergjent Komunal në mënyrë që ti plotësoj kërkesat që kanë ardhur në adresë të Shtabit, gjatë pandemisë COVID-19 dhe futjes së Komunës së Malishevës në karantinë, duke marr për bazë rrethanat e krijuar dhe kërkesat e shumta të qytetareve për miell kemi parë të arsyeshme që të sigurojmë miell andaj është bërë kërkesa dhe është nxjerr vendimi në vlerë prej 20.000 €.

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë kemi arritur përmbushjen e disa objektivave që kemi paraparë për vitin 2021. Në këtë raport të punës, po e paraqesim edhe numrin e kërkesave sipas llojit, kërkesa për ndërrim pronari, regjistrim dhe fshirje të hipotekave, kërkesa për ndarje e bashkim të parcelave, shumën e të hyrave të realizuara për periudhën kohore Janar – Maj 2021, si dhe shumë kërkesa tjera për dokumentacione e shërbime të cilat janë në autoritetin e kësaj drejtorie.

Po ashtu sa i përket punëve në shërbimin pronësor është duke vazhduar rilevimi i pronave publike dhe në të njëjtën kohë janë duke u zhvilluar procedurat për shqyrtimin e marrëdhënieve pasurore të krijuara me uzurpimin arbitrar të tokës në pronësinë shoqërore.

Në mënyrë tabelare po janë të paraqitura evidenca e punëve që janë kryer gjatë kësaj periudhe.

Numri i lëndëve dhe kërkesave të pranuar dhe shqyrtuara për periudhën Janar – Maj 2021, janë të paraqitura në tabelën si më poshtë:

Muaji	Certifikata të pronës	Certifikata sipas kërkesave zyrtare	Certifikata për raste sociale	Çertifikata që nuk ka pasuri	Çertifikata që nuk ka pasuri për raste sociale	Ndërrim i pronarëve dhe hipoteka	Ndërrim i pronarëve raste sociale	Kopje Plani	Koordinata	Historiate	Ndarje të parcelave	Ndërrim destinimi	Bashkim të parcelave	Rregullim i mezhdave	Rregullim i mezhdave kërkesa fshati	Kërkesa nga drejtorati	Ndarje të ngastrave raste sociale	Numri i përgjithshëm i kërkesave
Janar	26	9	6	19	75	74	/	19	9	1	2		2	/	5	/	/	247
Shkurt	39	47	4	7	88	52	/	23	15	2	3		/	/	1	1	/	282
Mars	132	20	6	27	68	75	/	68	13	3	/	5	/	/	3	9	/	429
Prill	210	30	2	16	60	44	/	4	9	1	5	5	/	/	1	/	/	387
Maj	11	5	1	12	35	47	/	4	7	1	3	2	/	/	5	/	/	133
Qershor																		
Korrik																		
Gusht																		
Shtator																		
Tetor																		
Nëntor																		
Dhjetor																		
Nr.përgj	418	111	19	81	326	292	/	118	53	8	13	12	2	/	15	10	/	1478

Më poshtë gjeni edhe disa foto të projekteve të realizuara dhe në realizim.



Edhe një shërbim për qytetarët e Malishevës kthehet në regjionin e Prizrenit



Komuna dhe KBI në Malishevë nënshkruan marrëveshjen për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2021



Riparohet salla e sportit në Gjimnazin “Hamdi Berisha”




Kanë filluar punimet në ndërtimin e trotuarit në Shkozë



Një vit nga regjistrimi i rastit të parë me covid në Malishevë




Ka filluar rregullimi i dy rrugëve në Dragobil dhe Banjë



Nënkryetari Berisha dhe drejtori Morina, inspektuan punimet në tri projekte



Ka filluar hapja e rrugës për lagjen Behraj në Carrallukë



Kanë filluar punimet në ndërtimin e aneksit të shkollës në Marali



U përurua objekti i shkollës “Habib Berisha” në Gurbardh të Malishevës



Begaj e Berisha panë nga afër mbjelljen e drunjëve në qytetin e Malishevës



Kryetari Ragip Begaj i ka parë nga afër realizimin e dy projekteve



Ka filluar ndërtimi i fushës së sportit në Shkozë të Malishevës



Ka filluar shenjëzimi në rrugët e qytetit në Malishevë



Ka filluar hapja dhe rregullimi i disa rrugëve në fshatin Burim të Malishevës



Ka filluar ndërtimi i trotuarit 2.7 km në Drenoc



U përrua salla e sportit në SHFMU “Ibrahim Mazrreku” në Malishevë



Nënkryetari Berisha inspektoi punimet në disa projekte në Komunën e Malishevës



Filloi fushata e dezinfektimit selektiv kundër rriqgrave



Filloi rregullimi i tetë segmenteve rrugore në Bellanicë



Po vazhdojnë punimet në rregullimin e hapësirës përgjatë lumit Mirusha në Malishevë



Çerdhja në Kijevë në përfundim e sipër



Edhe projekte tjera janë në realizim e sipër brenda vitit 2021.

Të nderuar qytetarë të Komunës së Malishevës, të gjithë ju dëshironi të jepni komente për këtë raport, këtë mund ta bëni përmes e-mailit zyrtar të Komunës së Malishevës, komuna.malisheve@rks-gov.net dhe kkmalisheve@gmail.com

Komentet, pyetjet dhe përgjigjet do të jenë publike, pas shqyrtimit nga ana e zyrës së kryetarit.

Ky raport, do të jetë i publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës së Malishevës, nga data 30.06.2021 dhe është i hapur për komente, për dy javë, nga dita e publikimit.